

D.S.H.S. GRAMSH
Nr 251 Dt 16.4.24



Për nën Ek



ILLYRIAN GUARD SH.A.

Nr. 518/5 Prot.

Datë 12/04/2024

Lënda: Mbi dërgimin e vendimit për Subjektin: "Drejtoria e Shërbimit Spitalor Gramsh"

Drejtoria e Shërbimit Spitalor Gramsh

Adresa: Rruga: Hamit Dollani

GRAMSH ✓

Për dijeni:

Agjencisë së Prokurimit Publik

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave,

TIRANË

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

Vendimin e Shoqërisë "Illyrian Guard" ShA për subjektin:
Drejtoria e Shërbimit Spitalor Gramsh.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,


ADMINISTRATORI

Anduel XHINDI


Në mungesë dhe me urdhër

Bledar HIMA





Për. nen Ek



ILLYRIAN GUARD SH.A.

Nr. 578/4 Prot.

Tiranë, më 12.04/2024

VENDIM

I mbajtur sot, në datë 12.04.2024, për shqyrtimin e kërkesës së subjektit publik **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Gramsh** me adresë: *Rruga Hamit Dollani Gramsh*, për përfitimin e shërbimit të sigurisë 1.3.A nga shoqëria “Illyrian Guard” ShA, nga Komisioni i ngritur me urdhër nr. 1529, datë 08.11.2022, “Për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e kërkesës së subjektive publike dhe private drejtuar shoqërisë “Illyrian Guard” ShA për shërbimin e sigurisë 1.3.A”, dhe Urdhërin nr.1027, datë 17.08.2023, “Për një ndryshim në urdhërin nr. 1529, datë 08.11.2022, “Për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e kërkesës së subjektive publike dhe private drejtuar shoqërisë “Illyrian Guard” ShA për shërbimin e sigurisë 1.3.A”, me pjesëmarrjen e:

- 1.1. Liridon Pula, Drejtor i Drejtorisë Tregëtare , Kryetar;
- 1.2. Qamil Abedin, Drejtor Teknik 1.3.A., Anëtar;
- 1.3. Aldi Qorri, Shef i Sektorit të Mirëmbajtjes Teknike të Sistemeve Anëtarë, Anëtarë;
- 1.4 Erjona Frashni, Sekretariat i këtij Komisioni

Komisioni, pasi u njoh me kërkesën e subjektit nr. 1833 prot (me tonën), datë 02.10.2023 “Kërkesë për ofrimin e shërbimit privat të sigurisë fizike me rroje dhe sisteme vëzhgim sinjalizimi” dhe praktikën e ndjekur lidhur me korrespondencën negociuese të mbajtur mes dy palëve, konkretisht:

1. Shkresë e Shoqërisë “Illyrian Guard” sha nr.1833/1, datë 04.10.2023 (protokolluar me tonën) “Kthim përgjigje”.
2. Shkresën e Subjektit nr. 1833/2, datë 16.10.2023 (protokolluar me tonën) “Mbi shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike të objekteve spitalore”.
3. Shkresë e Shoqërisë “Illyrian Guard” sha nr.1833/3, datë 25.10.2023 (protokolluar me tonën) “Kthim përgjigje”.
4. Shkresën e Subjektit nr. 578 datë 11.03.2024 (protokolluar me tonën) “Mbi shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike të objekteve spitalore”.
5. Shkresë e Shoqërisë “Illyrian Guard” sha nr. 578/1, datë 13.03.2024 (protokolluar me tonën) “Kthim përgjigje.”



ILLYRIAN GUARD SH.A.

6. Shkresën e Subjektit nr. 578/2, datë 11.04.2024 (protokolluar me tonën) “Kthim përgjigje”.

I. Vlerësim paraprak

Komisioni paraprakisht vlerëson në praktikën e Shoqërisë “Illyrian Guard” ShA, si më poshtë:

A. Në aspektin ligjor

1. Subjekti, bazuar në **Ligjin 75/2014**, datë 10.07.2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, dhe **VKM nr.177**, datë 04.04.2019 “Për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë “Illyrian Guard” ShA dhe për përcaktimin e autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të kësaj shoqërie” i është drejtuar shoqërisë “Illyrian Guard” Sh.A me kërkesën nr.1833 prot, datë 02.10.2023 (protokolluar me tonën) nëpërmjet së cilës kërkon ofrimin e shërbimit të sigurisë, si më poshtë:

- Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me një vendroje 24 orë nga e hëna të dielë dhe një sistem vëzhgimi sinjalizimi dhe verifikim me grup të gatshëm (Spitali, urgjenca dhe poliklina).
 - Fondi në dispozicion i subjektit është **5,040,550 Lek pa TVSH** për 12 muaj.
 - Shoqëria “Illyrian Guard” ShA nëpërmjet shkresës nr. 1833/1, datë 04.10.2024 me lëndë “Kthim përgjigje”, ka paraqitur përlllogaritjen financiare për shërbimin e ruajtjes dhe fondi i nevojshëm për të mbuluar këtë shërbim është **6, 316, 837,92** lek pa TVSH për 12 muaj ose me fondin në dispozicion mund të mbulohet shërbimi për 9 muaj e 17 ditë.
7. Subjekti përmes Shkresës nr. 1833/2, datë 16.10.2024 (protokolluar me tonën) “Kthim përgjigje” ka deklaruar se fondi i përlllogaritur nga Illyrian Guard Sha ka diferencë me fondin që disponon subjekti dhe nuk mund të përballohet prej tijë. Subjekti ka deklaruar se fondi që ka në dispozicion është për 12 muaj.
8. Shoqëria “Illyrian Guard” ShA nëpërmjet shkresës nr. 1833/3, datë 25.10.2024 me lëndë “Kthim përgjigje”, ka paraqitur përlllogaritjen financiare për shërbimin e ruajtjes me dy variante me fondin që subjekti ka në dispozicion: Variant 1 një vendroje me dy turne me koeficient 1.66 dhe shërbim sigurie me NVR 4 kanale dhe Alarm.



ILLYRIAN GUARD SH.A.

Variant II një vendroje me tre turne nga e hëna në të dielë dhe po nëpërmjet kësaj shkrese subjektit i është kërkuar parashkimi i fondeve të mjaftueshme për këtë shërbim.

9. Subjekti përmes Shkresës nr. 578, datë 11.03.2024 (protokolluar me tonën) “Kthim përgjigje shkresës 1833/3 datë 25.10.2023” ka deklaruar se variantet e paraqitura në shkresën e sipërcituar nuk përmbushin kërkesat e institucionit dhe se fondi në dispozicion mbetet **5,040,550 Lek pa TVSH për 12 muaj**.
10. Shoqëria “Illyrian Guard” ShA nëpërmjet shkresës nr. 578/1, date 13.03.2024 me lëndë “Kthim përgjigje” ka vënë në dijeni subjektin së tarifat e shërbimit janë të përcaktuara në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 90 , datë 27.6.2023 “Për miratimin e tarifave të reja të shërbimeve që u ofrohen subjekteve publike, nga Shoqëria “Illyrian Guard” ShA. dhe se është detyrim i Subjektit të buxhetojë fond për këtë shërbim.

 - Subjekti përmes Shkresës nr. 578/2, datë 11.04.2024 (protokolluar me tonën) ka deklaruar se shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike i kërkuar prej tij është një vendroje 24 orë nga e hëna të dielë dhe sistem vëzhgimi sinjalizimi në ambientet hyrëse-dalëse-pritëse (Spitali, urgjenca dhe poliklina), fondi në dispozicionin e subjektit është **5,040,550 Lek pa TVSH për 12 muaj**.

C. Në aspektin financiar

Lidhur me mënyrën e ruajtjes dhe sigurisë fizike të objekteve subjekti ka në dispozicion **5,040,550 Lek pa TVSH** për 12 muaj. Nëse do të ofrohej shërbimi sipas kërkesës së Subjektit duhet të disponont evlerën **6,316, 837,92** lek pa TVSH për 12 muaj.

- Kjo nënkupton që kontrata e lidhur me subjektin në fjalë, do të konsiderohej **kontratë negative** pasi një pjesë e konsiderueshme do të mbulohej nga të ardhurat e Shoqërisë “Illyrian Guard” ShA.

II. KONKLUZIONE

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve në aspektin ligjor dhe financiar, Komisioni vlerëson se procedura e ndjekur në këtë rast është në përputhje me aktet ligjore në fuqi.



ILLYRIAN GUARD SH.A.

Praktika në fjalë, **nuk përmbush kushtin financiar** pasi fondi që disponon subjekteti është i pamjaftueshëm për ofrimin e shërbimit me punonjës shërbimi sistemem vëzhgimi dhe sinjalizimi.

Shoqëria “Illyrian Guard” ShA si një shoqëri tregtare me qëllime fitime dhe garantuese e sigurisë, i ka ezauruar të gjitha etapat negociuese dhe mbështetur në:

- Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”
- Ligjin Nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 660 e vijues;
- Ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008 “Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;
- Ligjin Nr. 75/2014, datë 10.07.2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”,
- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar,
- VKM nr.177, datë 04.04.2019 “Për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë “Illyrian Guard” ShA dhe për përcaktimin e autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të kësaj shoqërie”,
- VKM-në nr. 275, datë 02.05.2019 “Për përcaktimin e kriterëve dhe kategorizimin e objekteve shtetërore, sipas mënyrës së ruajtjes e të sigurimit fizik të tyre”,
- Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 130, datë 5.3.2018 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”
- Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 90 , datë 27.6.2023 “Për miratimin e tarifave të reja të shërbimeve që u ofrohen subjekteve publike, nga Shoqëria “Illyrian Guard” ShA.
- Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë “Illyrian Guard” ShA,
- Kërkesën e subjektit nr. 1833 prot (me tonën), datë 02.10.2023 “Kërkesë për mbi shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike të objekteve”,
- Shkresë e Shoqërisë “Illyrian Guard” sha nr.1833/1, datë 04.10.2023 (protokolluar me tonën) “Kthim përgjigje”.
- Shkresën e Subjektit nr. 1833/2, datë 16.10.2023 (protokolluar me tonën) “Mbi shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike të objekteve spitalore”.
- Shkresë e Shoqërisë “Illyrian Guard” sha nr.1833/3, datë 25.10.2023 (protokolluar me tonën) “Kthim përgjigje”.



ILLYRIAN GUARD SH.A.

- Shkresën e Subjektit nr. 578 datë 11.03.2024 (protokolluar me tonën) “Mbi shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike të objekteve spitalore”.
- Shkresë e Shoqërisë “Illyrian Guard” sha nr. 578/1, datë 13.03.2024 (protokolluar me tonën) “Kthim përgjigje.”
- Shkresën e Subjektit nr. 578/2, datë 11.04.2024 (protokolluar me tonën) “Kthim përgjigje”.

VENDOSI:

1. Shoqëria “Illyrian Guard” ShA të shprehë pamundësinë e ofrimit të shërbimit të sigurisë për subjektin “**Drejtoria e Shërbimit Spitalor Gramsh**”, me kohëzgjatje 12 muaj brenda fondit të subjektit **5,040,550** lekë pa TVSH për 12 muaj.
- Shoqëria të bëjë me dije subjektin se “Illyrian Guard” ShA shpreh mundësinë e ofrimit të shërbimit të sigurisë për objektet e “**Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Gramsh**” sipas kërkesës së tijë me fond **6,316,837,92** lek pa TVSH për 12 muaj dhe se subjekti duhet të shtojë në Dokumentat Standarte të Tenderit fjalinë “Kjo marrëveshje kuadër dhe çdo minikontratë e lidhur me subjektin privat të shërbimit të sigurisë do të konsiderohet e zgjidhur nëse Shoqëria “Illyrian Guard” ShA shpreh mundësinë e ofrimit të shërbimit të sigurisë”.
2. Vendimi t’i dërgohet subjektit brenda tre ditëve nga dita e neserme e protokollimit të vendimit të Shoqërisë “Illyrian Guard” ShA dhe për dijëni Agjencisë së Prokurimit Publik.

KOMISIONI

1. Liridon Pula Kryetar
2. Qamil Abedin Anëtar
3. Aldi Qorri Anëtar